



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 qershor 2014  
Nr. ref.:RK641/14

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI211/13**

Parashtrues

**Demush Krasniqi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës,  
Njoftim nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Demush Krasniqi, me vendbanim në fshatin Drenoc, komuna e Malishevës, të cilin me autorizim e përfaqëson z. Daut Krasniqi, avokat nga komuna e Malishevës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi e konteston Njoftimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK), nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010, për largimin e tij nga posti i gjyqtarit në Gjykatën Komunale në Malishevë.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Njoftimit të KGJK-së nr. 01/118-682, të 27 tetorit 2010, ku si rezultat i riemërimit të gjyqtarëve, KGJK-ja, më 27 dhjetor 2010, ka njoftuar parashtruesin e kërkesës se mandati i tij si gjyqtar ka përfunduar.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 19 nëntor 2013, parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 3 dhjetor 2013, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 19 dhjetor 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë formularin zyrtar të Gjykatës.
8. Më 30 dhjetor 2013, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës.
9. Më 17 janar 2014, Gjykata njoftoi KGJK-në për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 28 mars 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Parashtruesi është ish-gjyqtar i Gjykatës Komunale në Malishevë, i cili më 27 tetor 2010 e mori Njoftimin nga KGJK-ja, nr. 01/118-682, me të cilin njoftohej se mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale në Malishevë përfundon më 27 tetor 2010.

12. Njoftimi i KGJK-së erdhi si rezultat i procesit të riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve përgjatë fazës së tretë, në bazë të nenit 2.11, nenit 2.16 dhe nenit 14.2 të Urdhërësës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe nenit 150 të Kushtetutës.

### **Pretendimet e parashtruesit**

13. Parashtruesi pretendon që me njoftimin e KGJK-së, *“është shkelur Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/25 Mbi Kornizën Rregullative për Sistemin e Drejtësisë në Kosovë të ( PSSP) si dhe neni 104 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët, neni 6 pika 1.2.3 dhe 4 Paga dhe mbrojtja sociale e gjyqtarëve profesionist”*.
14. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që *“njoftimin e KGJK-së ta shpall si kundërkushtetues e kundër ligjor dhe të më njohë të gjitha të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës që nga data e largimit e deri kur të vendoset me Vendim meritor”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

15. Për të qenë në gjendje që të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:  
*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
17. Gjithashtu nenin 47.2 të Ligjit, i cili parasheh:  
*“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.
18. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 36 (1) a) të Rregullores, i cili përcakton:  
*“(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:  
a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar...”*.
19. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata Kushtetuese vëren që më 27 tetor 2010, KGJK-ja e njoftoi parashtruesin, me anë të Njoftimit nr. 01/118-682, që mandati i tij si gjyqtar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Malishevë përfundoi më 27 tetor 2010.

20. KGJK-ja e bazoi lëshimin e këtij njoftimi në nenin 150 të Kushtetutës dhe në nenet 2.11, 2.16 dhe 14.2 të Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/25 mbi kornizën rregullative për sistemin e drejtësisë në Kosovë.
21. Gjykata, në këtë drejtim, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi se ka kontestuar vendimin e KGJK-së në ndonjërin nga gjykatat e rregullta të Kosovës apo që ka shteruar ndonjë mjet efektiv juridik para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
22. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për kërkesën e shterimit të mjeteve juridike është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih rastin *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803194, GJEDNJ, vendimi i 28 korrikut 1999).
23. Gjykata zbatoi të njëjtin arsyetim, kur nxori aktvendimin për papranueshmëri, në bazë të asaj se nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike në rastin (shih rastin KI104/10, *Vahide Badivuku kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, Aktvendimi për papranueshmëri, të 14 qershorit 2011).
24. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Ligj, që të mund të dorëzojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese dhe kërkesa duhet të hidhet si e papranueshme në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) a) të Rregullores.
25. Gjykata gjithashtu vëren që edhe sikur parashtruesi të ketë shteruar të gjitha mjetet e tij juridike para se të parashtronte këtë kërkesë në Gjykatë më 19 nëntor 2013, kërkesa e tij do të ishte e papranueshme sepse nuk ishte parashtruar brenda afatit prej katër (4) muajve siç është paraparë me ligj. Shih nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 28 mars 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani